
	Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo  Komuna e Prishtinës Opština Priština –Municipality of Prishtina	
---	--	---

<b>Datë/a:</b>	13.05.2020
<b>Për/ Za/ To:</b>	“Saba Belca-Dega në Kosovë&SB Construction&Gurebardhi”
<b>CC:</b>	Departamenti i Prokurimit
<b>Nga/ Od/ From:</b>	Zekë Bardhaj – Udhëheqës i Departamentit të Prokurimit – Komuna e Prishtinës
<b>Tema/ Subjekat/Subject:</b>	Vendim për Rishqyrtim të Kërkesës

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Prishtinës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.2) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas **kërkesës për rishqyrtim** të datës 12.05.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik “Saba Belca-Dega në Kosovë-SB Construction&Gurebardhi”, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Vazhdimi i rrugës B**”, me Nr. të Prok: **616 19 1015 511** nxjerr:

## V E N D I M

**1. Refuzohet në tërësi si e pa e bazuar kërkesa për rivlerësim e parashtruar nga ” Saba Belca-Dega në Kosovë-SB Construction&Gurebardhi” e dates 12.05.2020 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Vazhdimi rruges B”, me Nr. të Prok: 616 19 1015 511 , kundër Vendimit te AK –së, të datës 08.05.2020.**

**2. Mbetet në fuqi vendimi i AK datë: 08.05.2020.**

**3. Autoriteti Kontraktues, vendos që aktivitetin e prokurimit me titull “Vazhdimi i rrugës B”, me Nr. të Prok: 616 19 1015 511 ”ta vazhdoj sipas njoftimit te dates 08.05.2020.**

**4. Ky Vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën : <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.**

**A r s y e t i m**

Autoriteti Kontraktues – Komuna e Prishtinës me datë 13.05.2020 ka shqyrtuar kërkesën e grupit të OE-ik “Saba Belca-Dega në Kosovë-SB Construction&Gurebardhi” dhe ka konstatuar si vijon:

-Pretendimi juaj se Autoriteti Kontraktues nuk ka respektuar dispozitat e neneve nga Ligji i Prokurimit publik janë të pa qëndrueshme për arsyet në vijim:

-Së pari ashtu si që e keni paraqitur edhe ju kërkesa e pikës 9.2 nga FDT-ja ka qenë që OE-ik duhet të ketë realizuar kontrata të ngjajshme(të ndërtimit të ulët)në tri vitet e fundit(duke filluar nga data e publikimit të njoftimit për kontratë).Dita e publikimit të njoftimit për kontratë ka qenë 03.12.2019 dhe nga kjo rrjedh se periudha për kontratat e pranueshme është nga data 03.12.2016 deri me datën 03.12.2019 dhe sipas kësaj pretendimi juaj se referencat e datave 19.12.2016 dhe 20.12.2016 janë të pa pranueshme është krejtësisht i pa bazuar.Lidhur me këtë dua t’ua sqaroj se në Vendimin për refuzimin e rekomandimit të komisionit për rivlerësim i kam cekur të gjitha referencat e pranueshme me data të pranimit dhe poashtu janë cekur të gjitha pozicionet e pranueshme nga kontratat me Ministrinë e Infrastrukturës.

-Pastaj pretendimet tjera tuaja lidhur me kualifikimet dhe angazhimin e stafit janë të pa pranueshme për arsyet në vijim:

-Mungesa e ndonjë nënshkrimi edhe nëse paraqet ndonjë devijim kemi të bëjmë me devijime të vogla që nuk kanë rëndësi(sipas nenit 59),ndërsa angazhimi i ndonjë profesionisti me kualifikim më të lartë nuk paraqet asnjë shkelje,përkundrazi është në favor të realizimit më të sukseshëm të projektit.Poashtu angazhimi i ndonjë eksperti që është i punësuar nuk paraqet asnjë shkelje pasi që nuk ka asnjë dispozitë ligjore që nuk e lejon angazhimin në punë plotësuese.

Nga të gjitha analizat e pretendimeve tuaja kam konstatuar se Autoriteti Kontraktues nuk ka shkelur asnjë nga dispozitat që ju keni pretenduar dhe si të tilla janë të pa qëndrueshme.

**Bazuar në sqarimet paraprahe u vendos si në dispozitiv të Vendimit.**

**Për shkakë të pandesmisë deklaroj se ky dokument ka të njëjtën barasvlerë si dokument i nënshkruar.**

**Këshillë juridike:Pala e pakënaqur me Vendimin mund të parashtroj ankesë në Organin Shqyrtues të Prokurimit në afat prej dhjetë(10)ditëve nga dita e pranimit të këtij Vendimi.**

Udhëheqësi i Prokurimit  
(Zekë Bardhaj)